

Fondet për ushqim për Transfertat Elektronike të Benefiteve për Pandeminë (P EBT) për vitin shkollor 2022-2023

A mund të marr P-EBT?



Do të merrni P-EBT nëse studenti juaj:

- Ka marrë P-EBT në të shkuarën,
- Kualifikohet për vakte falas ose me çmim të reduktuar sipas Programit Kombëtar për Drekë në Shkollë (NSLP), ose
- Shkon në një shkollë që i ka vaktet falas për të gjithë studentët (Dispozita Komunitare për Kualifikim - CEP)*, DHE
- Nuk ka shkuar në shkollë për arsye që lidhen me COVID-in. Shembujt përfshijnë:
 - Studenti ishte me COVID, iu desh të karantinohej, apo nuk shkoi në shkollë sepse kishte simptoma si të COVID-it dhe/ose priste një test negativ
 - Shkolla e studentit ishte mbyllur përkohësisht dhe mësimi vazhdonte në distancë

Për kualifikimin për P-EBT informacionet konfidenciale shëndetësore mbi mungesat për shkak të COVID-it nuk ndahen me shtetin.

*Për momentin vaktet në shkollë janë falas për të gjithë studentët për shkak të rregullave të veçanta të COVID-it. Vizitoni MAp-EBT.org për listën e të gjitha shkollave ku zbatohen CEP. Kontaktoni shkollën për të aplikuar për NSLP nëse nuk keni marrë P-EBT në të kaluarën dhe shkolla juaj nuk zbaton CEP.

Sa mund të marr?

Varet sa ditë ka munguar studenti në shkollë për arsye që lidhen me COVID-in:

1-5 mungesa = \$25/muaj

6-15 mungesa = \$82/muaj

16+ mungesa = \$1147/muaj

Si & dhe kur do t'i marr fondet?



- Pagesat e P-EBT do të jetë në dispozicion më 25 qershor
- Nëse keni marrë P-EBT në të shkuarën, kontrolloni kartën që keni nga P-EBT ose kartën e Transfertave Elektronike të Benefiteve nga Departamenti për Asistencë Kalimtare (DTA EBT).
 - Keni nevojë për një kartë të re nga DTA EBT? Kërkoni një nga DTA Connect, telefononi **877-382-2363** ose shkoni te një zyrë e Departamentit për Asistencë Kalimtare (DTA)
 - Keni nevojë për një kartë të re nga P-EBT? Vizitoni DTAConnect.com/pebt ose telefononi **877-382-2363** dhe shtypni 7
- **Nëse jeni i ri tek P-EBT:** kontrolloni postën tuaj për një kartë P-EBT ose, nëse merrni benefite DTA, kontrolloni kartën tuaj të DTA EBT.

Marrja e P-EBT & SNAP nuk do të ketë ndikim mbi ju apo mbi statusin e emigracionit të fëmijës suaj. Nuk do të keni asnjë problem nëse merrni këto benefite. P-EBT të verës po vijnë. Mbajeni kartën tuaj.

MAp-EBT.org • Linja e DTA për Ndihmë 877-382-2363 (shtypni “7”)

Merrni më shumë para mujore për ushqim me SNAP - deri në \$939 për një familje me 4 anëtarë. Mund të merrni P-EBT & SNAP njëkohësisht. MAp-EBT.org/SNAP

